

Nr. 3330 Prot.Elbasan, më 04.12.2020**Protokoll bashkëpunimi midis:****Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" dhe Qendrës së Testimit S.T.A****1. Parime të përgjithshme**


Ky protokoll bashkëpunimi lidhet sot më 20.11.2020, në Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", midis Rektorit, **Prof.Dr. Skender Topi** dhe **Ines Dika**, përfaqësuese e S.T.A (CMD of ETS Tests)

Neni 1**Baza Ligjore**

Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor" në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë nenit 76 pika 4 dhe nenit 78 pika 3, Udhëzimi nr. 52, datë 03/12/2016 të MAS "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në Institucionet e arsimit të lartë".

Neni 2**Objekti dhe qëllimi i protokollit të bashkëpunimit**

Objekti i këtij protokollit është të garantojë bashkëpunimin midis UNIEL-së dhe qendrës së testimit S.T.A (CMD of ETS Tests), me qëllim sigurimin e standardit gjatë procesit të testimit të gjuhës angleze dhe të garantojë çertifikimin zyrtar të rezultatit të arritur gjatë testimit, si parakusht për përfundimin e suksesshëm në programet e studimit të ciklit të dytë (Master) dhe të tretë (Doktoraturë) dhe si kusht hyres në programet Master dhe Doktoratë, që ofrohen në këtë universitet.



Neni 3
Kohëzgjatja e Protokollit

Ky protokoll lidhet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vitesh, me të drejtë përsëritje me marrëveshje të palëve.

Neni 4
Detyrimet e S.T.A

1. Merr përsipër të çertifikojë studentët e UNIEL në formatin e testimit "**paper based**" CERFL dhe përkatësisht variantin e testit, **TOEIC L&R** (shih: www.ets.org).
2. Siguron që studentët që do të aplikojnë për testim, të deklarojnë personalisht online, në <http://registration.sta-edu.com/>, të dhënat personale si emër, mbiemër, numrin e kartës së identitetit, vendlindjen etj.
3. Siguron testimin vetëm të studentëve që vijnë ose do të vijnë programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në Universitetin "Aleksander Xhuvani".
4. Paraqet të dokumentuar zyrtarisht rezultatin (pikët e testimit) të studentëve në Rektorat, nëpërmjet **Score Roster** dhe **Çertifikatë**.
5. Merr përsipër, nëpërmjet një staffi tërësisht amerikan, korrigjimin e testeve, administrimin dhe shpërndarjen e rezultateve të testimit.
6. Kujdeset për mirëmbajtjen e ambienteve të testimit të studentëve të vëna në dispozicion nga universiteti.
7. Merr përsipër ruajtjen e të dhënave që ka në dispozicion në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" si dhe konventat ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi.
8. Merr përsipër vlerësimin e testit sipas kriterëve të vlerësimit dhe niveleve të miratuara në Udhëzim Nr. 52, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
9. Dëshmshpërblen universitetin në rastin kur ky i fundit konstaton se është cënuar baza materiale e universitetit gjatë zhvillimit të testimit.
10. Nuk cënon normalitetin e zhvillimit të procesit mësimor duke i zhvilluar testet vetëm në datat e përcaktuara në Kalendarin e zhvillimit të testeve të miratuar nga Rektorati.
11. Pas nënshkrimit të protokollit certifikon UNIEL si Qendra e Autorizuar e Testimit

Neni 5
Të drejtat e S.T.A

1. S.T.A për zhvillimin e testeve të gjuhës angleze ka të drejtë të përdorë sallën e përcaktuar nga UNIEL
2. S.T.A ka të drejtë të publikojë në ambientet e universitetit dhe në <http://www.uniel.edu.al/>, datat e zhvillimit të testeve dhe listën e testeve të ETS

Neni 6
Detyrimet e Universitetit


1. Ofron ambientet e universitetit me qëllim garantimin e respektimit të standardeve dhe të cilësisë së testimit.
2. Merr përsipër ruajtjen e të dhënave personale dhe të rezultateve të testimit të cilat vihen në dispozicion në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" si dhe legjislacionin në fuqi.
3. Miraton kalendarin e zhvillimit të testeve dhe cakton një koordinator për mbarëvajtjen e këtij protokolli.
4. Publikon në ambientet e universitetit dhe në <http://www.uniel.edu.al/>, datat e zhvillimit të testeve dhe listën e testeve të ETS të njohura ndërkombëtarisht në zbatim të ligjit për Arsimin e Lartë dhe Udhëzimit të MAS, nr. 52, datë 03.12.2015 si dhe nivelet e kompetencës gjuhësore përkatëse për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë.
5. Merr përsipër të pajisi me diploma studentët që përfundojnë studimet ose hyjnë në programet e ciklit të dytë ose të tretë, vetëm pasi të jenë pajisur me çertifikimin e lëshuar nga ETS, në zbatim të ligjit për Arsimin e Lartë dhe udhëzimit të MAS.

Neni 7
Të drejtat e Universitetit

Universiteti ka të drejtën të kërkojë dëmshpërblim monetar kur konstaton se është cënuar baza materiale e universitetit sipas një proces verbali të mbajtur, që dëshmon dëmin e shkaktuar.

Neni 8
Procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Në rast se njëra nga palët, Universiteti ose S.T.A, kërkon të zgjidhë kontratën e bashkëpunimit, atëherë ajo duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim të paktën 30 ditë përpara ndërprerjes së marrëveshjes. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve zgjidhen në gjykatë.



Neni 9
Respektimi i detyrimeve

Palët zotohen të zbatojnë me përpikëri dispozitat e parashikuara në këtë protokoll.

Neni 10

Protokolli përpilohet në 3 (tre) kopje, nga të cilat dy i mban universiteti dhe një qendra e Testimit S.T.A

Neni 11

Protokollit i bashkangjitet kopja e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe S.T.A (CMD of ETS Tests), datë 20/11/2020.

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

R E K T O R I

Prof.Dr. Skender TOPI



S.T.A

Përfaqësuese

Prof.Ass. Ines DIKA



(Authorized Test Ceter)